

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)**Buletini Nr. 18/ 2023, 18-01-2023****Parashikimi** nga 18-01-2023, ora 12:00 deri më 19-01-2023, ora 23:59.**PARASHIKIM I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET**

Sipas llogaritjeve hidrologjike të IGJEO-s, si rezultat i reshjeve me intensitet të lartë, të rëna gjatë dy ditëve të kaluara, të cilat do të vazhdojnë edhe sot dt.18 Janar dhe nesër dt.19 Janar, do të ketë rritje të prurjeve në lumenjtë e mëdhenj dhe të mesëm Drin-Buna, Mat dhe Vjosë. Lumenjtë Drin-Buna dhe Liqeni i Shkodrës do të vazhdojnë të kenë prurje dhe nivele të larta. Për pasojë pritet përkeqësimi i hartës së përmbytjeve në pjesën e Nën Shkodrës dhe përmbytjes të zonave periferike të qytetit të Shkodrës në afërsi të Liqenit. Për arsye të shtimit të rrezikut nga përmbytja, është vendosur të mbahet shenja e paralajmërimit nga përmbytja për qarkun e Shkodrës.

Rrezik të shtuar për përmbytje në vazhdim të ditës së sotme dhe të nesërme do të ketë dhe në lumin Vjosa.

Në lumenjtë Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Seman pritet një rritje e prurjeve, por që nuk përbën rrezik për përmbytje.

Në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë pritet të ketë vërshime të shpejta të lumenjve si dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane të këtyre qarqeve pritet të ketë përmbytje të lokalizuara në varësi të gjendjes së kanalizimeve. Ky informacion do të përditësohet nga IGJEO sipas llogaritjeve më të fundit hidrologjike dhe do të njoftoheni për çdo ndryshim në parashikimin e përmbytjeve.

**PARASHIKIMI METEO****RESHJET**

Sot pasdite (e mërkurë, dt.18) dhe nesër (e enjte, dt.19) priten reshje shumë intensive në qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë, intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë dhe Elbasan, ndërsa mesatare deri lokalisht intensive në qarqet e tjera. Në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë reshjet priten të shoqërohen edhe me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

**TEMPERATURAT**

Nesër (e enjte, dt.19) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë: në bregdet: 13 / 17 °C; në vendet e ulëta: 12 / 14 °C; në vendet malore: 6 / 10 °C

**ERA**

Sot pasdite (e mërkurë, dt.18) dhe nesër (e enjte, dt.19) era pritet të fryjë e mesatare deri e fortë, sidomos në bregdet dhe në zonat malore.

**NIVELET E RREZIKUT****S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: Elvin Çomo

Koordinator: Alban Doko ( Tel: +355 69 311 9392, e-mail: [albania.hazards@gmail.com](mailto:albania.hazards@gmail.com))

faqe 1 / 3

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (Bulletin on Natural Hazards)

























Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 18/ 2023, 18-01-2023

Parashikimi nga 18-01-2023, ora 12:00 deri më 19-01-2023, ora 23:59.

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**


RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive					
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive					
DIBËR	S'KA RREZIK	intensive					
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive					
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare					
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
ELBASAN	S'KA RREZIK	intensive					
FIER	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
VLORË	S'KA RREZIK	shumë intensive					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	shumë intensive					

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

<b>Niveli i Rrezikut</b>	<b>Reshje shiu</b> (mm / 24 orë)
<b>S'KA RREZIK</b>	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I ULËT</b>	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I MODERUAR</b>	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
<b>I LARTË</b>	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

<b>S'KA RREZIK</b>	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
<b>ULËT</b>	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
<b>I MODERUAR</b>	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
<b>I LARTË</b>	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 18 – 19.****SIMBOLE**

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke